




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration


Për :	Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Nasuf Aliu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, U.d. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 04/04/2019
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	020-379
Lloji i aktit:	Vendim	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 100/19 për aprovimin e Memorandumit të Mirëkuptimit
I miratuar më datë: 28.03.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.04.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



Za :	Xhafer Tahiri, gradonačelnik Opštine Vučitrn Nasuf Aliu, predsedavajući Skupštine opštine	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>B. Begolli</i> Roza Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a, <i>Begolli</i>	
Od:	Venera Çerkini, v.d rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i i monitorisanje opština, MALS <i>[Signature]</i>	Datum, 04/04/2019
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Vučitrn	020-379
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 100/19 za odobrenje Memoranduma o razumevanju
Usvojena dana, 28.03.2019. godine
Predložana za razmatranje u MALS-u dana, 04.04.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 8, paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenin 12, paragrafi 2, pika "d" në lidhje me nenin 28 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41, paragrafi 2, pika "ç" në lidhje me nenin 40, paragrafi 1, pika "i" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më, 28 mars 2019, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

1. Me këtë vendim aprovohet memorandumi i mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Obiliqit, Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Podujevës.
2. Qëllimi i këtij memorandumi të mirëkuptimit është rregullimi i rrugës Stanoc, Breznicë, Kozaricë, Barilevë Lupç i Poshtëm, në gjatësi prej 14 km e që shtrihet në territorin e komunave të përfshira në këtë memorandum të mirëkuptimit.
3. Autorizohet Kryetari i komunës që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit, si dhe t'i marrë përsipër obligimet që burojnë nga ky dokument me qëllim të implementimit të këtij memorandumi të mirëkuptimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



KOMUNA
VUSHTRRI



KOMUNA
OBILIQ



KOMUNA
PRISHTINËS



KOMUNA
PODUJEVËS

MEMORANDUM MIRËKÛPTIMI

Neni 1
Palët nënshkruese

1. Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
2. Komuna e Obiliqit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
3. Komuna e Prishtinës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës
4. Komuna e Podujevës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës

Neni 2

Qëllimi i Memorandumit

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit në mes të katër (4) Komunave është Rruga Stanovc, Breznicë, Kozaricë, Barilevë, Lupçë i poshtum (gjatësia e përafërt e rrugës është 14 km) e cila shtrihet në territorin e komunave të përfshira në këtë Memorandum Mirëkuptimi, dhe si qëllim kanë që përmes këtij Memorandumi të rregullohet kjo rrugë shumë e rëndësishme për këto zona dhe komunitetin që jetojnë në këto territore. Po ashtu ky memorandum mirëkuptimi, ka për qëllim që të shërbejë si urë lidhëse në mes katër Komunave të lartcekura, duke përfshirë edhe shkurtimin e km për qytetarët e këtyre zonave dhe gjithë banorëve të Republikës së Kosovës dhe me gjerë. Me rastin rregullimit të kësaj rruge në interes të përgjithshëm do të krijohet një lehtësim si në sferën e rrugëtimit por edhe në shtruarjen e aktiviteteve turistike, rekreative, kulturore dhe biznesore mes qytetarëve të këtyre 4 komunave.

Neni 3

Obligimet e palëve nënshkruese

Në bazë të memorandumit të mirëkuptimit, palët nënshkruese obligohen të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm për pjesën e rrugës që gjendet në territorin e tyre dhe njëkohësisht të shprehin gatishmërinë për bashkëpunim në realizimin e projekteve të përbashkëta si dhe të krijojnë lehtësira. Palët nënshkruese po ashtu obligohen që të llobojnë dhe të kërkojnë nga Qeveria e Republikës së Kosovës mjete financiare për ndërtimin e rrugës 14 kilometra për t'i lehtësuar investimet në këtë zonë.

Neni 4

Ndërtimet i Rrugës Stanovc-Breznicë-Kozaricë-Lupçë i poshtumë

Ndërtimi apo (restaurimi) i kësaj rruge në këto zona, fillimisht lehtëson qarkullimin e qytetarëve dhe më pas edhe krijimin e zonave turistike, biznesore dhe kulturore me rëndësi për banorët e këtyre zonave. Rruga do të vazhdohet në rrugën ekzistuese dhe në rast të ndonjë ndryshimi do të ipet prioritet atyre pjesëve . në të cilën qarkullimi është më i lehtë.

Neni 5

Zgjidhja e kontesteve

Palët pajtohen në mes vete që ky Memorandum i Mirëkuptimit, të zgjidhet mes vete me mirëkuptim duke krijuar dhe lehtësira pronësore.

Neni 6
I tërë mirëkuptimi

Teksti i këtij Memorandumi është e vetmja e pajtuar në mes të palëve dhe asgjë në këtë marrëveshje nuk nënkupton heqjen dorë nga një e drejtë, obligim apo kompetencë e paraparë me legjislacionin në fuqi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese pajtohen që ky Memorandum i Mirëkuptimit mund të filloj së zbatuari që nga dita e nënshkrimit të saj.

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (4) kopje dhe secilës palë nënshkruese i dorëzohet nga një (1) kopje.

Kryetar i Komunës

Kryetar i Komunës

Kryetar i Komunës

Kryetar i Komunës

Xhafer Gashi

Xhafer TAHIRI

Shpend Ahmeti

Agim Veliu